



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 1095 Prot.

Tiranë, më 26/03/2018

Lënda: Përcillet shqetësimi i thellë për pengimin e veprimtarisë së kontrollit parlamentar nga ana e disa anëtarëve të Këshillit të Ministrave.

Drejtuar:

Z. Edi Rama
Kryeministër i Shqipërisë

Z. Gramoz Ruçi
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Për dijeni:

Z. Taulant Balla
Kryetar i Grupit Parlamentar të PS-së

Z. Edmond Spaho
Kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së

Z. Petrit Vasili
Kryetar i Grupit Parlamentar të LSI-së

Z. Fatmir Mediu
Kryetar i Grupit Parlamentar të PR-së

Në vëmendje:

SH.S. Znj. Romana Vlahutin
Shefe e Delegacionit të Bashkimit Europian, Tiranë

SH.T.Z. Donald Lu
Ambasador i SHBA, Tiranë

SH.T.Z. Bernd Borchardt
Drejtues i Prezencës së OSBE, Tiranë
Të gjitha Ambasadave të vendeve anëtarë të BE-së në Tiranë

I nderuar Z. Rama,
I nderuar Z. Ruçi,

Neni 7 i Kushtetutës sanksionon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe nën dritën e këtij parimi, merr përparësi funksioni i kontrollit parlamentar, i cili nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë, sipas

rasteve konkrete. Për këtë qëllim, Kushtetuta e ka pajisur Kuvendin në tërësi, por edhe pakicën parlamentare në veçanti, me mekanizma konkret të realizimit të këtij kontrolli parlamentar. Nëse pakicës parlamentare, i heq mundësinë e kontrollit parlamentar, atëherë jemi përpara eliminimit faktik kushtetues të saj, dhe goditjes më të rëndë të parlamentarizmit dhe demokracisë në vend.

Neni 80, pika 3 e Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin kushtetues që *"drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për sa e lejon ligji"*. Ky detyrim kushtetues është detajuar edhe në Rregulloren e Kuvendit, ku përcaktohet mënyra sesi mund të realizohet kjo e drejtë kushtetuese e komisioneve parlamentare.

Konkretisht, pika 2 e nenit 32 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, parashikon se: *"Mbledhjet e komisionit të përhershëm thirren edhe me kërkesën e jo më pak se 1/4 së anëtarëve të Komisionit, duke përcaktuar në kërkesë dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje"*, ndërkohë neni 36 i saj parashikon se: *"Komisioni është i detyruar të zhvillojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim"*.

Në zbatim të këtyre rregullave, në disa raste, pakica parlamentare dhe në çdo rast jo më pak se 1/3 e anëtarëve të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, kanë thirrur në seancë dëgjimore ministrat përgjegjës, për të dhënë shpjegime dhe sqarime për probleme të caktuara. Kjo e drejtë e Komisionit buron edhe nga pika 2 e nenit 102 të Rregullores së Kuvendit, ku specifikohet se: *"Komisionet kanë të drejtë të thërrasin në çdo kohë ministrat, për të dhënë shpjegime dhe sqarime për probleme të fushave ku ata janë individualisht përgjegjës, si dhe për zbatimin e ligjeve, të vendimeve, rezolutave ose deklaratave të miratuara nga Kuvendi. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve, japin shpjegime dhe informojnë për çështje që lidhen me veprimtarinë e tyre"*.

Komiteti i Përbashkët i Stabilizim Asociimit BE – Shqipëri, në takimin e 12-të të zhvilluar në Tiranë në datat 12 dhe 13 shkurt 2018, në Rekomandimet e tij kërkoi me forcë *"një rol më të madh të Parlamentit Shqiptar në procesin e anëtarësimit në BE, duke përfshirë monitorimin dhe zbatimin e reformave dhe përputhshmërisë me standartet e BE si dhe sigurimin e përfaqësimit të duhur të opozitës"*.

Për sa më lart, edhe pse Rregullorja e Kuvendit ia njeh të drejtën deputetëve kërkues që të caktojnë ditën dhe orën e thirrjes në Komision të ministrit përgjegjës për një çështje të caktuar (neni 32 i Rregullores), në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, kam kërkuar në çdo rast që dita dhe ora të rakordohet midis stafit të Kuvendit dhe stafit të ministrit përgjegjës, në varësi të axhendës së Komisionit dhe ministrit përkatës. Në shumë raste kemi propozuar që në çdo moment të ditës (paraditë, pasdite apo mbrëmje) që anëtari I kabinetit do të gjente kohë të lirë, do të mbledhim komisionin në mbledhje. Mirëpo, në mënyrë të përsëritur disa ministra, edhe në raste kur kanë konfirmuar prezencën në Komision në ditën dhe orën e rënë dakord bashkërisht, ose nuk paraqiten fare ose njoftojnë vetëm disa orë përpara zhvillimit të mbledhjes së planifikuar të Komisionit, se nuk mund të paraqiten, dhe dërgojnë në mbledhje përfaqësues të tjerë të ministrisë.

Rasti më tipik i kësaj sjellje, është refuzimi i përsëritur për t'u paraqitur në Komision, i Ministres së Arsimit dhe Sportit znj. Lindita Nikolla dhe Ministres së Kulturës znj. Mirela Kumbaro. Kjo ka shkaktuar shtyrje të pajustificuara, të herë pas herëshme të mbledhjeve të Komisionit, për shkak se deputetët kanë thirrur në seancë dëgjimore ministrin përgjegjës, që sipas nenit 102/4 të Kushtetutës, brenda drejtimit kryesor të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Refuzimi i përsëritur nga ana e

Ministrave e ka bërë shpesh të pamundur trajtimin në Komisionin Parlamentar të disa prej problematikave të mprehta në Arsim, Kulturë etj. Në këtë rast, detyrimi për t'u paraqitur në Komision, sa herë deputetët kërkojnë sqarime nga Ministri për një çështje, bën pjesë në rrethin e detyrimeve që Ministri nuk mund t'ia delegojë një zyrtari tjetër. Gjithashtu, detyrimi kushtetues për të dhënë sqarime në Komisionin përgjegjës parlamentar, është me natyrë prioritare dhe duhet të vlerësohet si i tillë nga ana e Ministrit, për shkak se ka të bëjë me përmbushjen e një funksioni kushtetues të Kuvendit, siç është funksioni i kontrollit parlamentar.

Kështu, vetëm në 2 muajt e fundit, Ministrja e Kulturës znj. Kumbaro dhe Ministrja e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë znj. Nikolla kanë refuzuar të paraqiten në Komisionin Parlamentar të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik përkatësisht:

- **22 janar 2018** - Seancë dëgjimore me Ministren e MASR, në lidhje me nismën "3 lëndë për 6 orë". **Ministrja Nikolla refuzon të paraqitet në Komision;**
- **29 janar 2018** - Seancë dëgjimore me Ministren e MASR, në lidhje me nismën "3 lëndë për 6 orë". Deputetët e PS nuk vijnë në Komision për shkak të mbledhjes së Grupit Parlamentar të tyre;
- **19 shkurt 2018** – Seancës dëgjimore me Ministren e Kulturës, në lidhje me dëmtimet e disa monumenteve të kulturës për shkak të rreshjeve të ditëve të fundit, si dhe zhvendosjen e artistëve të skenës dhe Teatrit Kombëtar te Teatri "Turbina". **Ministrja Kumbaro refuzon të paraqitet në Komision;**
- **5 shkurt 2018** - Seancë dëgjimore me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me implementimin e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij. **Ministrja Nikolla refuzon të paraqitet në Komision;**
- **14 shkurt 2018** - Seancë dëgjimore (kontroll parlamentar) - Seancë dëgjimore me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lindita Nikolla, në lidhje me implementimin e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij. **Ministrja Nikolla refuzon të paraqitet në Komision;**
- **12 mars 2018** - Seancës dëgjimore me Ministren e Kulturës në lidhje me çështjen e prishjes së Teatrit Kombëtar - **Ministrja Kumbaro refuzon të paraqitet në Komision;**
- **13 mars 2018** - Seancës dëgjimore me Ministren e Kulturës në lidhje me çështjen e prishjes së Teatrit Kombëtar - **Ministrja Kumbaro refuzon të paraqitet në Komision;**
- **20 mars 2018** - Seancës dëgjimore me Ministren e Kulturës në lidhje me çështjen e prishjes së Teatrit Kombëtar - **Ministrja Kumbaro refuzon të paraqitet në Komision.**

Kontrolli parlamentar, i cili kryesisht ushtrohet nga opozita, cilësohet si "kompetencë kushtetuese" e kësaj të fundit. Duke e veshur opozitën me këtë pushtet, Kushtetuta "... institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare", që realizohet "... në mënyrë të pavarur..." dhe që është "... i pakufizuar nga vullneti i shumicës apo Qeverisë". E drejta e kontrollit parlamentar i është njohur pakicës parlamentare, e cila, duke i pasur të kufizuara mjetet, "mandat shpërndarë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues".

Ushtrimi normal i veprimtarisë së Kuvendit kërkon ekzistencën e elementeve të domosdoshëm që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për respektimin e ligjeve nga të gjitha organet e tjera të pushtetit publik e shtetasit, si dhe pajisjen e tij me mjetet e përshtatshme për realizimin e kontrollit mbi mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe mbrojtjen e interesit publike. Thirrja për të dhënë sqarime në Komision të Ministrat përgjegjës, në kuptim të nenit 80 të Kushtetutës, është një mjet që i shërben pikërisht ushtrimit të kontrollit parlamentar, si dhe llogaridhënies së Qeverisë. Ai është instrument i rëndësishëm i parlamentit për mbledhjen e informacionit për çështje të veçanta, me qëllim arritjen në përfundime të caktuara. Për pasojë, **inJORIMI I KËSAJ TË DREJTE TË OPOZITËS DHE KËTIJ DETYRIMI KUSHTETUES TË MINISTRIT, PËRBËN AKT INJORIMI NDAJ AUTORITETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË DHE SI I TILLË ËSHTË NJË AKT THELLËSISHT ANTIKUSHTETUES DHE QË PASSJELL PËRGJEGJËSI POLITIKE DHE DISIPLINORE NDAJ MINISTRIT.**

Dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj gjithashtu, se kjo sjellje është vijim i akteve të tjera të pengimit të funksionit të kontrollit parlamentar nga ana e Qeverisë. Deputetëve të opozitës, i mohohet rast pas rasti edhe dhënia e informacioneve në vijim të kërkesave për informacion në Ministri apo institucione të tjera të ekzekutivit, në përputhje me nenin 94 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenin 8 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, "Statusi i deputetit", i ndryshuar, ku specifikohet se: *"Deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij, nga ministrat ose nga drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore, si dhe nga drejtuesit e çdo institucioni tjetër në administratën publike ose të qeverisjes vendore. Drejtuesit e institucioneve janë të detyruar t'i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës"*. Në shumë raste, informacioni ose nuk përcillet fare, me justifikime të paligjshme, ose përcillet i paplotë, duke na penguar në ushtrimin e funksionit tonë si përfaqësues të sovranitetit të Popullit. **Edhe kjo sjellje përbën akt inJORIMI ndaj autoritetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe si i tillë është një akt thellësisht antikushtetues dhe që passjell përgjegjësi politike dhe disiplinore ndaj ministrat apo titullarit të institucionit.**

Nga analiza e situatës konstatohet se këto veprime janë identike në të gjitha ministrat dhe nga të gjithë Ministrat, çka krijon bindjen e arsyeshme se kemi të bëjmë me një veprim të koordinuar në nivel qeveritar dhe një akt të dakordësuar qeveritar. Në këtë kuptim, jemi përpara rastit tipik ku Qeveria ka vendosur të shpërfillë autoritetin e Kuvendit dhe të pengojë opozitën parlamentare të përmbushë misionin e saj në një vend demokratik. Në këtë pikë sjellim në vëmendjen tuaj se funksionimi normal i Kuvendit, dhe mbi të gjitha qeverisja transparente, është tregues bazë i demokracisë funksionale, dhe si i tillë një nga kushtet për ecimin pozitiv të Shqipërisë në rrugën e saj europiane.

Për këtë arsye, kërkojmë:

- Nga ana e Kryeministrit, marrjen e masave për ministrat përgjegjës si më sipër, mbajtjen e një qëndrimi institucional dhe publik mbi këtë sjellje të paprecedentë të Ministrave të tij, si dhe marrjen e masave për mos përsëritjen në të ardhmen të situatave të tilla nga ministrat apo titullarët e institucioneve në varësi të tij.
- Nga ana e Kryetari i Kuvendit, që të mbajë qëndrim institucional dhe publik mbi këtë çështje dhe të kërkojë nga ministrat dhe titullarët e institucioneve që të respektojnë të drejtat kushtetuese të deputetëve dhe të përmbushin detyrimet e tyre kushtetuese për t'u paraqitur në Komision sa herë kërkohet dhe të japin informacionet e kërkuara, në përputhje me Kushtetutën, ligjin dhe Rregulloren e Kuvendit.

Së fundmi, ju bëjmë me dije se opozita parlamentare nuk është e gatshme të heqë dorë nga ushtrimi i përgjegjësi dhe të drejtave të veta kushtetuese, dhe nuk mund të bëhet fasadë për një qeverisje jo transparente apo të pranojë inJORIMIN e rolit të Kuvendit nga ana e pushtetit ekzekutiv.

Në këtë drejtim, në rast se situata të tilla përsëriten në të ardhmen, apo nga ana juaj nuk mbahet qëndrimi i duhur institucional dhe kushtetues, ju bëjmë me dije se reagimi ynë do të jetë propocional dhe politik, në mbrojtje të vlerave kushtetuese, demokracisë funksionale dhe rolit të Kuvendit në një Republikë Parlamentare.

Me shpresën për zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit nga ana juaj,

**KRYETARE E KOMISIONIT PËR EDUKIMIN DHE MJETET E INFORMIMIT
PUBLIK**

ALBANA VOKSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1095/ Prot.

Tiranë, më 16.03.2018

Lënda: Dërgohet shkresa e deputetes.

DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN
AMBASADËS SË SHBA-së
PREZENCËS SË OSBE-së
AMBASADËS SË AUSTRISË
AMBASADËS SË BULLGARISË
AMBASADËS SË ÇEKISË
AMBASADËS SË DANIMARKËS
AMBASADËS SË FRANCËS
AMBASADËS SË GJERMANISË
AMBASADËS SË GREQISË
AMBASADËS SË HOLLANDËS
AMBASADËS SË HUNGARISË
AMBASADËS SË ITALISË
AMBASADËS SË KROACISË
AMBASADËS SË MALTËS
AMBASADËS SË POLONISË
AMBASADËS SË RUMANISË
AMBASADËS SË SLLOVAKISË
AMBASADËS SË SLLOVENISË
AMBASADËS SË SPANJËS
AMBASADËS SË SUEDISË
KËSHILLIT TË EUROPËS

TIRANË.

Ju dërgojmë bashkëlidhur shkresën e deputetes së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Albana Vokshi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ
(Në mungesë dhe me autorizim)
DREJTOR I SHËRBIMIT TË SEANCAVE PLENARE

Mimoza PAÑO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1095 Prot.

Tiranë, më 16.03 2018

Lënda: Dërgohet shkresa e deputetes.

KËSHILLIT TË MINISTRAVE
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

TIRANË

Ju dërgojmë bashkëlidhur shkresën e deputetes së Kuvendit të Shqipërisë znj. Albana Vokshi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ
(Në mungesë dhe me autorizim)

DREJTOR I SHËRBIMIT TË SEANCAVE PLENARE

